



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

# BULETINI MUJOR I SEMUNDSHMERISE INFEKTIVE

(Pasqyra 14 Sh)

SEKTORI I EPIDEMIOLOGJISE

GUSHT, 2018

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 të çdo muaji. Te dhënat e agreguara të pasqyrës 14 sh për muajin Gusht janë të dhënat e raportuara nga te 36 rrethet e vendit.

## 1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjate muajit Gusht 2018 zënë 63.93% të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me ane të Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidencë 484.62/100.000 banorë. Dihet që periudha e muajve të nxehte të vitit mbart me vete frekuencën me të larte të episodeve diarreike dhe në muajin gusht vihet re një rritje e sëmundjeve diarreike ku peshën kryesore e mbajnë gastroenteritet e paspecifikuara dhe helmimet ushqimore me një incidencë përkatësisht për muajin gusht 2018 në nivel kombëtar, 465.30/100.000 banorë dhe 15.78/100.000 banore. Gastroenteritet e paspecifikuar janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit.

Në muajin gusht janë raportuar pese raste të dyshuara me Tifo abdominale, vetëm një rast është i konfirmuar. Dy raste u raportuan nga DSHP Lushnjë dhe tre raste nga DRSHP Vlore, të cilët morën masat përkatëse në vatër.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës jotifoide për muajin gusht 2018 me incidence 1.45/10.000 banore ndjekur nga Elbasani (0.85/10.000 banore), Fieri (0.30/10.000 banore), Vlora (0.32/10.000 banore) dhe Gramshi (0.41/10.000 banore). Te gjitha rastet janë të konfirmuara.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin gusht 2018 në nivel kombëtar përkatësisht me incidencë 2.59/10.000 banorë, ndjekur nga Kukesi me incidence 0.2/10.000 banore.

Ndërkohe që në nivel kombëtar toksikoinfektionet alimentare paraqesin një incidencë 15.78/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Elbasan, Kavajë, Kukës dhe Tirane mbajnë peshën kryesore në raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike në Gusht 2018 (Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Gusht 2018	Incidenca Gusht 2018 (raste/100.000 banore)
Tifo abdominale + Paratifo	5	0.18
Salmoneloza	50	1.79
Shigeloze (Disenteri bacilare)	44	1.57
Dizenteri amebike	0	0


Toksikoinfeksione alimentare	442	15.78
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	13029	465.30
Semundje diarreike ne total	13570	484.62

## 2. Sëmundjet e EPI

### 2.1. Fruthi

Gjatë muajit gusht 2018 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 22 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv vetëm 14 raste. Rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë, në ISHP.

Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, Gusht 2018



Peshën kryesore sipas shpërndarjes gjeografike të rasteve të dyshuara dhe të konfirmuara me fruth e mban Tirana, Vlora dhe Pogradeci.

## 2.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit gusht 2018 janë raportuar 18 raste me Tuberkuloz pulmonar dhe 3 raste me Tuberkuloz ekstrapulmonar, me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Grupmosha e prekur është ajo adulte. Nga 18 raste të suspektuara 9 janë të konfirmuar me Tuberkuloz pulmonar dhe tre rastet me Tuberkuloz ekstrapulmonar janë të suspektuara.

## 3. Zoonozat

Ne nivel vendi incidenca e Brucelozës është 0.29/100.000 banorë. Rastet për muajin gusht 2018 janë raportuar nga rrethet Lushnjë, Librazhd, Vlore, Gjirokastrë, Kolonjë dhe Korçë. Gjatë muajit gusht në pasqyrën 14 sh është raportuar një rast i konfirmuar me Antraks nga rrethi i Sarandës i grupmoshës 55-59 vjeç.

Ndërkohë gjatë kësaj periudhe janë suspektuar shtate raste dhe janë konfirmuar prej tyre vetëm tre raste me Leptospirozë. Rastet janë raportuar nga Berati, Fieri, Librazhdi, Mallakastra dhe Tirana.

Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike në gusht 2018 (Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste, Gusht 2018	Incidenca Gusht 2018 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	1	0.04
Brucelozë	8	0.29
Leptospirozë	7	0.25
Leishmaniaza viscerale	1	0.04
Leishmaniaza kutane	0	0

## 4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit gusht 2018 janë raportuar në total 14 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.50/100.000 banorë) nga të cilat 6 raste janë Hepatite virale të paspecificuar dhe 1 rast Hepatit viral akut A dhe 7 raste Hepatit viral B.

Ne lidhje me HBV, 7 rastet i përkasin grupmoshave: 35-34 vjeç (1 rast), 25-29 vjeç (1 rast), 35-39 vjeç (2 raste), 40-44 vjeç (2 raste) dhe 55-59 vjeç (1 rast). Dy raste me HBV të konfirmuar kanë raportuar përkatësisht Shkodra, Mallakastra, Durrësi dhe një rast të konfirmuar ka raportuar Tirana.

## 5. Meningoencefalite

Gjatë muajit Gusht 2018 janë raportuar në total 4 raste me meningoencefalite përkatësisht, nga Tirana, Durrësi, Lushnja dhe Vlora. Rastet kanë predominim në grup moshën pediatrike krahasuar me moshën adulte, në raportin

3:1. Vetem nje rast ka rezultuar meningit meningokoksik nga Tirana, ndersa rastet e tjera kane qene te dyshuara, 2 raste meningite virale dhe nje rast i dyshuar meningit bakterial.

## 6. Sëmundjet virale me vatra natyrore

**Ethe hemorragjike virale:** gjate muajit Gusht 2018 kemi patur tre raste te dyshuara me Ethe hemorragjike virale. Rastet kane nje shperndarje gjeografike, 1 rast nga Korca, 1 rast nga Has dhe nje rast Breglumi Kukes. Rastet kane qene te grup-moshës 25-44 vjec, 45-59 vjec dhe 65+ vjec. Shperndarja sipas gjinise femra ne raport me meshkuj eshte 1:2. Persa i perket natyres profesionale, vetem nje rast ka qene me profesion blegtor nderkohe dy rastet e tjera kane qene shtepiake.

Sipas protokollit te hetimit dhe testimi virologjik te rasteve per Ethe Hemorragjike Kongo Krime vetem nje rast ka rezultuar pozitiv ne ELISA dhe PCR.

## 7. HIV/AIDS

Gjate muajit gusht 2018 ne Laboratorin Referencës HIV/AIDS, ISHP Tirane, janë konfirmuar 12 raste te reja me HIV+ te grup-moshës 28-71 vjeç. Gjashte raste janë nga Tirana. Nga rastet e ardhura për testim ne ISHP shtate janë te referuar nga Reparti i Infektivit, QSUT, nje rast nga Banka e Gjakut Tirane dhe katër raste nga spitale dhe laboratorë private ne Tirane. Ne pasqyrën 14 sh janë raportuar vetëm dy raste pozitiv me HIV përkatësisht nga Librazhdi dhe Shkodra,

Hartoi: **Departamenti i Kontrollit te Sëmundjeve Infektive, Sektori i Epidemiologjisë.**

Silvia Bino, Eugena Tomini, Artan Simaku, Adela Vasili, Luljeta Alla, Elona Kureta, Rovena Daja, Marjeta Dervishi.

Editoi: Rovena Daja

INSTITUTI I  
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI